



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-008

Prishtinë, më 21 janar 2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 JANAR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Jasmina Zhivković, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljević, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Në fillim të mbledhjes, kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të datës 12 prill 2013, që ka të bëjë me pjesëmarrjen e deputetëve në seancë plenare, përkatësisht me obligimet që u përkasin atyre gjatë votimit në seancë plenare. Ai kërkoi nga të pranishmit konsensus që të respektohet aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me këtë çështje diskutuan: Glauk Konjufca, Adem Grabovci, Visar Ymeri, Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11, 16, 17, 18 dhjetor 2014, si dhe 14 dhe 19 janar 2015
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11, 16, 17, 18 dhjetor 2014, si dhe 14 dhe 19 janar 2015

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 11, 16, 17, 18 dhjetor 2014, si dhe 14 dhe 19 janar 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 23 janar 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike,
8. Debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.6 Kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, për realizimin e përfitimeve të ish-zyrtarit të lartë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e ish-kryetarit të Kuvendit gjatë legjislaturave III dhe IV, z. Jakup Krasniqi, për realizimin e të drejtave të përfitimeve të ish-zyrtarit të lartë, mori këtë:

V E N D I M

- I. Ish-kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjatë legjislaturave III dhe IV, z. Jakup Krasniqi, i takojnë përfitimet e ish zyrtarit të lartë, si në vijim:
 1. Paga mujore në lartësi prej 70% të pagës aktuale të kryetarit të Kuvendit.
 2. Një (1) asistent i lartë, një (1) vozitës dhe një (1) trupprojë, të cilët zgjidhen nga ish-kryetari i Kuvendit dhe paguhen sipas legjislacionit për shërbimin civil.
 3. Një (1) veturë.
 4. Një hapësirë e përshtatshme - zyrë e mobiluar dhe e pajisur.
 5. Shpenzimet e komunikimit, telefoni dhe interneti, deri në shumën 1 200€ në vit.
 6. Një (1) vit, të drejtë të kërkojë mbrojtje në pajtim me ligjin.
- II. Të drejtat e parapara në pikën (I) një të këtij vendimi realizohen nga data 18 korrik 2014.

3.7 Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së dhe të deputetëve tjerë nënshkrues, për debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Republikës së Kosovës

Kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së dhe të deputetëve tjerë nënshkrues për debat parlamentar lidhur me migrimin ilegal të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Kryesia e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 23 janar 2015.

* * *

Pikat tjera të mbetura nga shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave Kryesia i shtyu për mbledhjen e radhës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për çështje plenare dhe procedurale